



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:111220

Datë: 29.08.2024

Numri i dokumentit: 06101146

PAKR.nr.50/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti i Krimeve të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Afërdita Bytyçi - Kryetare e kolegjit, Vaton Durguti dhe Skender Çoçaj - anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bajram Rexhahmetaj, në çështjen penale kundër të pandehurve E.G. dhe A.G, të akuzuar për veprën penale, Vrasje në tentativë nga neni 172 e lidhur me nenin 28 e 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (më tej KPRK-së), pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, gjykata e ka rikualifikuar veprën penale në raport me të pandehurin E. G. në veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 e lidhur me paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të KPRK-së, ndërsa ndaj të pandehurit A.G e ka rikualifikuar veprën penale në veprën penale Sulmi sipas nenit 184 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e ushtruar nga përfaqësuesi i palës së dëmtuar S.B av. Sh.Z., ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit A.G av. L.K.G. dhe mbrojtëses së të akuzuarit E. G. av. S.K.S., të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Krimeve të Rënda, P.nr.130/2023 të datës 24.11.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK-së, me datë 20.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesa e përfaqësuesit të palës së dëmtuar S.B av. Sh.Z., ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit A.G av. L.K.G. dhe ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit E.G av. S.K.S., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Krimeve të Rënda, P.nr.130/2023 të datës 24.11.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin P.nr.130/2023 të datës 24.11.2024, të akuzuarin A.G për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe të akuzuarin E. G. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me paragrafin 1 e nën paragrafin 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës i ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënimet si në vijim:

Të pandehurit A.G;

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në këtë dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 16.05.2023 e deri më 25.10.2023.

Të pandehurit E. G.;

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në këtë dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 16.05.2023 e deri më 25.10.2023.

Janë obliguar të pandehurit që në mënyrë solidare të paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej 100 (njëqind) euro, shpenzimet e procedurës penale, si në vijim, për ekspertime mjeko - ligjore shumë prej 170 (njëqindeshatëdhjetë) euro, për pjesëmarrjen e ekspertit në seancë, shumë prej 200 (dyqind) euro. Gjithashtu të pandehurit obligohen që secili veç e veç të paguajnë shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro për taksë për Fondin për kompensimin e viktimave të krimit. Të cilat obligohen t'i paguajnë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Është aprovuar baza e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarit S.B, me të dhënat personale siç konstatohen në shkresat e lëndës. Lidhur me llojin dhe lartësinë e dëmit është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Në mbështetje të nenit 282 paragrafi 1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, është urdhëruar konfiskimi i përhershëm i sendit (thikës) e cila është sekuestruar nga i pandehuri A.G. Pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, kjo thikë duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, në bashkëpunimin me Prokurorinë Themelore në Mitrovicë.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar S.B av. SH.Z. për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të vendimit mbi sanksionin penal me propozim që Gjykata e Apelit të Kosovës të aprovoj ankesën si të bazuar ashtu që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet apo i njëjti të anulohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i rëndë apo çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje për shkak të shkeljeve të KPPKRK-së.

Mbrojtësja e të akuzuarit A.G av.L.K.G., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe vendimit mbi sanksionin penal me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj ashtu që të akuzuarin A.G ta liroj nga akuza.

Mbrojtësja e të akuzuarit E. G. av. S.K.S., për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal me propozim që Gjykata e Apelit të Kosovës të aprovoj ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj ashtu që të akuzuarit E. G. t'i shqiptohet një dënim më i ulët.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën PPA/I.nr.65/2024 të dt. 31.01.2024, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e përfaqësuesit të palës së dëmtuar S.B av. SH.Z. ashtu që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarve t'iu shqiptohet dënimi më i rëndë ose aktgjykimi të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje, ndërsa ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit A.G av. L.K.G. dhe ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit E.G. av. S.K.G., të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-së, në të cilën kanë prezantuar i akuzuari A.G, mbrojtësi i të akuzuarit av. L.K.G., mbrojtësja e të akuzuarit S.K.S., i dëmtuari S. B., përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar av. K.S.ndërsa

nuk ka prezantuar askush nga Prokuroria e Apelit si dhe i akuzuari E. G. të cilët kanë qenë të njoftuar me rregull për ditën dhe kohën e mbajtjes së seancës.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, shkresat e lëndës, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPRK-së, vlerësoi pretendimet ankimore të paraqitura nga përfaqësuesi i palës së dëmtuar S.B av. SH.Z., mbrojtësja e të akuzuarit A.G av. L.K.G. dhe mbrojtësja e të akuzuarit E.G. av. S.K.S. dhe pas analizimit dhe vlerësimit të tyre gjeti se: **Ankesat janë të pabazuara.**

Pretendimet ankimore

Në ankesë përfaqësuesi i palës së dëmtuar S.B av. SH.Z. thekson se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale kjo për faktin se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i pa kuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij dhe me arsyet e aktgjykimit në raport me të akuzuarit E. dhe A.G; dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me vetveten dhe me arsyetimin në raport me të akuzuarit e lartëcekur, në aktgjykimin e ankimuar nuk janë paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare, kurse ato që janë paraqitur janë plotësisht të paqarta dhe kundërthënëse dhe jo të sakta në masë të konsiderueshme; për faktet vendimtare ka kundërthënie të konsiderueshme dhe thelbësore ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar lidhur me përmbajtjen e shkresave dhe procesverbaleve për deklaratimet e dhëna në procedurë penale-seancën kryesore para trupit gjykues dhe palëve në procedurë dhe vet këtyre shkresave dhe procesverbaleve. Gjykata e shkallës së parë nuk ka paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë dhe të saktë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Gjykata e shkallës së parë gjithashtu nuk ka bërë vlerësimin e saktësisë së provave e veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprave penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarve si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarve dhe gabimisht ka vepruar kur ka bërë ricilësimin e veprës penale nga Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së në veprën penale Sulm nga neni 184 par. 1 për të akuzuarin A.G dhe veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nënparagrafi 1.4 të KPRK-së, me këtë rikualifikim gjykata ka bërë shkelje të kodit të procedurës penale për faktin se ka vepruar në kundërshtim me nenin 359 dhe 360 të KPPRK-së, për faktin se gabimisht është thirrur kur ka thënë se kualifikimi i veprës penale është bërë në bazë të nenit 359 par.2 të KPPRK-së për faktin se ky paragraf i këtij neni nuk ka të bëjë

asgjë me kualifikimin e veprës penale, gjithashtu gabimisht ka vepruar edhe lidhur me nenin 360 par.1 sepse ky paragraf thotë se aktgjykimi duhet t’iu referohet vetëm personave të akuzuar dhe se në rastin konkret në aktakuzë kanë qenë të cekur se cilët janë personat e akuzuar të cilët i di edhe vetë trupi gjykues prandaj me këto veprime kjo gjykatë ka vepruar në kundërshtim me KPPRK-në. Gjykata gjithashtu, në mënyrë të veçantë vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse, arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve, si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij”. Mbrojtja e të dëmtuarit me të drejtë konsideron se një mori elementesh faktike nuk janë vlerësuar drejtë, e nëse janë vlerësuar janë vlerësuar në bazë të kriterëve të njëanshme që gjykata e shkallës së parë i ka aplikuar me rastin e vlerësimit, andaj janë edhe të pa qëndrueshme, ngase është bërë vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike e që e tërë kjo ka rezultuar si pasojë e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale. Mbi këto rrethana mbrojtja ka propozuar si më lartë.

Në ankesë mbrojtësja e të akuzuarit A.G av. L.K.G. thekson se Gjykata e shkallës së parë gjatë shqiptimit të dënimit nuk ka pasur parasysh rrethanat lehtësuese, pasi që i akuzuari A.G që nga fillimi i hetimeve, ngritja e aktakuzës dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ishte ngarkuar me veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, mirëpo trupi gjykues pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, ka bërë “rikualifikimin e veprës penale nga Vrasja në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, në veprën penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së. Mbrojtja konsideron që gjykata e shkallës së parë, në vlerësimin e rrethanave rënduese dhe lehtësuese nuk ka bërë shqiptimin e dënimit analog me këto rrethana, fillimisht duke iu referuar të gjeturave të gjykatës në lidhje me rrethanat rënduese të cilat i ka vlerësuar siç janë: shkalla e lartë e dashjes së shprehur nga të pandehurit në këtë rast, motivi i sulmit si shkak i problemeve të mëhershme me të dëmtuarin, përgjegjësia dhe përgjegjshmëria e plotë e tyre, kontributi esencial për veprimet e tyre, cenimi i vlerës së mbrojtur e që është cenuar personaliteti dhe integriteti trupor i të dëmtuarit, mënyra e kryerjes së veprës penale, ndërsa si rrethana lehtësuese për të akuzuarin A.G ka vlerësuar se i njëjti nuk ka qenë më parë i dënuar për ndonjë vepër penale, nuk njihet për precedent penal, ka treguar sjellje shumë korrekte, sulmi i tij ndaj të dëmtuarit nuk ka rezultuar me pasojë. Mbrojtja konsideron se gjykata e shkallës së parë sipas vlerësimit të rrethanave të lartëcekura, për të akuzuarin A.G nuk ka shqiptuar dënim adekuat dhe në përputhje me të gjitha rrethanat e sipërshënuara, po ashtu konsideron se i akuzuari A. është dashur të lirohet nga akuza pasi që nuk ka prova me të cilat do të vërtetohej se i njëjti

ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë. Vepra penale e cila i vihet në barrë nuk përmban elementet qenësore të veprës penale Sulmi nga neni 184 par. 1 të KPRK-së, pasi që i akuzuari nuk ka qenë i përfshirë në këtë rast, mirëpo vetëm ka ndërhyrë që të ndaj vëllain e tij E. G. me të dëmtuarin S. B., dhe se nuk ka pasur asnjëherë problem me të dëmtuarin dhe nuk do të ketë as në të ardhmen. Këto rrethana fare nuk është dashur të vlerësohen si rrethana rënduese dhe të merren parasysh me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, andaj sikur gjykata të mos i konsideronte si rrethana rënduese vendimi mbi dënim do të ishte shumë më i favorshëm për të akuzuarin dhe i njëjti do të duhej të lirohej nga akuza. Me aktgjykimin e ankimuar nuk është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë as gjendja faktike. Ç'është e vërteta i akuzuari A.G nuk ka marrë pjesë në rrahje, por vetëm ka ndërhyrë që t'i ndaj vëllaun e tij E. G. dhe të dëmtuarin S. B. Mbrojtja tutje shton se me aktgjykimin e ankimuar nuk është vërtetuar as kryerja e veprës penale Sulmi nga neni 184 par. 1 të KPRK-së, e po me këtë aktgjykim është bërë edhe shkelja e ligjit penal në dëm të të akuzuarit A.G, i njëjti është shpallur fajtor për veprën penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, edhe pse me asnjë provë materiale nuk është vërtetuar se i njëjti ka kryer këtë vepër penale me të cilën ngarkohet. Mbrojtja konsideron se edhe sikur gjykata të gjen se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, për të cilën është shpallur fajtor, vendimi mbi dënim është tejet i ashpër si pasojë e mos vlerësimit adekuat të rrethanave lehtësuese të cilat ndikojnë në lartësinë e dënimit dhe vlerësimit të gabuar të rrethanave rënduese. Mbi këto rrethana ka propozuar si më lartë.

Mbrojtësja e të akuzuarit E. G. av. S.K.S. në ankesë thekson se Gjykata e shkallës së parë gjatë shqiptimit të dënimit nuk ka arritur që të vërtetoj se i akuzuari E. G. kishte për të kryer veprën penale që i vihet në barrë sipas akuzës së prokurorisë, ngase gjatë zhvillimit të kësaj procedure penale, prokurori i shtetit ka dështuar që ta mbroj aktakuzën në fjalë, për arsye se në këtë procedurë penale as nga dëshmia e dëshmitarit/të dëmtuarit, as pas administrimit të provave të propozuara nga prokurori i shtetit, as nga provat materiale, as nga dëshmia e ekspertit mjekoligjor në lidhje me lëndimet e të dëmtuarit dhe të akuzuarit nuk është vërtetuar dashja e të akuzuarit për ta kryer veprën penale që i vihet në barrë - Vrasja në tentativë dhe si rrjedhojë e kësaj Gjykata e shkallës së parë pas analizimit të gjitha provave një nga një dhe të gjitha së bashku ka arritur të vërtetoj se i akuzuari E.G. me të vërtetë nuk e kishte kryer veprën penale sipas akuzës së prokurorisë. Pas përfundimit të kësaj çështje penale në harmoni me shkresat e lëndës, dëshminë e të dëmtuarit, të mbrojturit tim dhe të akuzuarit tjetër A.G kishte bërë rikualifikimn e veprës penale nga ajo e Vrasjes në tentativë në atë të "lëndim i lehtë trupor" nga 185 par.2 c lidhur me par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së.

Sipas mbrojtjes *gjendja faktike* në këtë çështje nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë edhe të plotë sipas nenit Neni 386 të KPPRK-së, gjykata e shkallës së parë lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, si rrethanë rënduese kishte marr shkallën e lartë të dashjes së të pandehurit, motivin e sulmit si shkak i problemeve të mëhershme me të dëmtuarin, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë të akuzuarit, mirëpo e njëjta nuk kishte arritur që të vlerësoj saktë gjendjen faktike ngase e gjithë ngjarja kishte ndodhur nga provokimet e të dëmtuarit dhe se ngjarja kishte ndodhur rastësisht, aty për aty. Në rastin konkret cila do të ishte dashja për të kryer veprën penale që të akuzuarit i vihet nëbarrë, kur i njëjti që nga policia, por edhe në seancë, në gjykatore, kishte deklaruar se të dëmtuarin e kishte takuar disa herë pas konfliktit që kishin pasur para dy vitesh për pronën për të cilën e kishte blerë i akuzuari dhe tani është pronar legjitim, e kinse është motivi apo burimi i këtij problemi. Gjykata e shkallës së parë nuk vlerësuar mjaftueshëm kredibilitetin e të dëmtuarit në këtë çështje penale, të kaluarën kriminale të tij, motivin e kryerjes së veprës penale se i dëmtuari kishte përmendur konfliktin e mëparshëm me të akuzuarin për pronë e cila tash e sa vite është pronë legjitime e të akuzuarit dhe se nuk kishte as logjikë që konflikti të vazhdonte për një çështje që më nuk mund të jetë as temë diskutimi.

Gjykata e shkallës së parë kishte vepruar drejt kur kishte bërë rikualifikimin e veprës penale me që i njëjti veprim ishte në harmoni me të gjeturat e këtij shqyrtimi gjyqësor por që lidhur me veprën penale Lëndim i lehtë trupor mbrojtja konsideron se dënimi i shqiptuar është i lartë ngase qëndrimi i të akuzuarit gati për 6 muaj në paraburgim tani më ka arritur qëllimin e dënimit dhe se do të ishte gabim që të mendojmë se i akuzuari kishte një vepër të rëndë penale me akuzën e prokurorisë dhe se tani dënimi prej një 1 viti burgim do të ishte i kënaqshëm. Mbrojtja kërkon nga gjykata e shkallës së dytë që me rastin e analizimit të gjendjes faktike të merret parasysh se i akuzuari E. gjatë seancës kishte shprehur keqardhje, faktin se edhe i akuzuari kishte lëndime trupore, se me rastin e shpalljes së aktgjyqimit nga Gjykata i akuzuari kishte qajtur në gjykatore e kjo është një faktor shumë i rëndësishëm dhe tejet i vërtetë se i njëjti ishte penduar për veprimet e tij, se koha e qëndrimit në paraburgim ishte shumë e rëndë për të, se kishte fëmijët e vegjël dhe bashkëshorten të cilët i kishte lënë vetëm kështu edhe duke i mbetur punët bujqësore që janë burim i vetëm i të ardhurave. Tutje kërkon që të merret parasysh edhe bashkëpunimi i të akuzuarit dhe korrektësia e të njëjtit i cili kishte deklaruar të vërtetën që nga fillimi i kësaj procedure penale, duke e vërtetuar ekspertiza e mjekësisë ligjore mjetin e përshtatshëm që i akuzuari E. e kishte deklaruar që nga fillimi e që ishin çelësat e veturës që i

kishte pasur me vete dhe se me të e kishte goditur. Sipas mbrojtjes Gjykata e Apelit të Kosovës duhet të ketë parasysh se dënimi i shqiptuar nga Gjykata e shkallës së parë është i rëndë, dhe tejet i lartë, prandaj kjo gjykatë të shikoj mundësinë e uljes së dënimit, pasi që bazuar në dispozitat ligjore të KPRK-së, neni 71, shprehimisht përcaktohet se: Gjykata mund të shqiptoj dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit: 1.1. kur ligji parasheh që dënimi i kryesit mund të zbutet apo të zvogëlohet; meqë i akuzuari është mbajtës kryesor i familjes, dhe se dënimi i shqiptuar do të jetë një barrë shtesë për të akuzuarin dhe se një vendim i tillë do të ndikonte edhe në mirëqenien e tij pasi që në rastin konkret nuk ka prova me të cilat do të vërtetohej se i akuzuari të ketë kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, i njëjti për këtë çështje ka mbajtur pesë (5) muaj paraburgim që do të thotë se ndaj të njëjtit është arritur qëllimi i dënimit. Mbi këto rrethana mbrojtja ka propozuar si më lartë.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore janë të pabazuara, dhe nuk qëndrojnë shkeljet e pretenduara të dispozitave të procedurës penale për të cilat sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, e të cilat do të kishin kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit rikujton se në drejtim të trajtimit të ankesës së palës së dëmtuar për bazat tjera të ankesës, gjykata i ka trajtuar vetëm në drejtim të vendimit mbi sanksionin penal, si përcakton dispozita e nenit 381 par.3 të KPP-ës, ndërsa në raport me pretendimet ankimore të dhe mbrojtëses së të akuzuarit A.G av. L.K.G. përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, kjo Gjykatë gjeti se të njëjtat nuk qëndrojnë, ngase dispozitivi i aktgjykimi është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, po ashtu, i njëjti është në përputhshmëri të plotë edhe me arsyetimin e tij. Ndërsa, në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar janë dhënë arsyet të qarta mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje penale-juridike, duke vepruar kështu konform dispozitës të nenit 369 par. 6 dhe 7 të KPPK-së, ku, gjykata e shkallës së parë, ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit dhe atë si ato faktike ashtu edhe ato juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë.

Gjykata e shkallës së parë, ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë.

Sa i përket pretendimeve ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike të paraqitura nga mbrojtësja e të akuzuarit A.G av. L.K.G., kolegji penal i kësaj gjykate gjen se, gjykata e shkallës së parë edhe gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë për shkak se, me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari A.G ka kryer veprën penale Sulm nga neni 184 par.1 të KPRK-së dhe E. G. ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 e lidhur me par.1 nenpar.1.4 të KPRK-së, me ç'rast gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë dhe ligjshëm duke marrë aktgjykim me të cilin të akuzuarit i ka shpallur fajtor dhe i ka dënuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, kjo pasi që nga provat e administruara është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit A.G përmbushen elementet e veprës penale Sulm nga neni 184 par.1 të KPRK-së dhe në veprimet e të akuzuarit E. G. përmbushen elementet e veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 e lidhur me par.1 nenpar.1.4 të KPRK-së.

Kjo Gjykatë vlerëson si të drejta përfundimet e gjykatës së shkallës së parë e cila deri tek kjo gjendje faktike ka ardhur pas administrimit të provave personale dhe atë:

Nga dëshmia e të dëmtuarit S.B i cili ndër të tjera ka deklaruar se pas konfliktit verbal me të pandehurin E. i cili kishte ndodh afër bankës “T.”, ka vendos që ta denoncoj rastin dhe është nisur të shkoj në stacionin policor në V. Sipas tij, afër stacionit policor është takuar me dy të pandehurit të cilët edhe e kanë sulmuar fizikisht. Për këto rrethana të ngjarjes, i dëmtuari ka deklaruar; *“Jam nisur për ta lajmëruar rastin në polici, pas fjalosjes te banka “T.”, para stacionit policor, kanë ndalur dy të pandehurit. Fillimisht A. më ka sulmuar me grushta duke më goditur nëpër pjesë të ndryshme të trupit e më pas, E. i e ka nxjerr thikën dhe ka tentuar të më godet në fyt. I pandehuri E. me ka goditur në dorën e majtë dhe në kokë në anën e majtë me thikë. Kam qenë i gjakosur dhe një kalimtar i rastit me ka dërguar në Spitalin e qytetit”*. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, i dëmtuari në mënyrë të hollësishme ka përshkruar veprimet e të pandehurve në këtë rast. I dëmtuari ka thënë se, i pandehuri A. me grushta e ka sulmuar në pjesë të ndryshme të trupit. Ndërsa, i pandehuri E. me një thikë e ka godit në kokë dhe në dorën e majtë. Gjithashtu, i dëmtuari ka thënë se, si pasojë e këtij sulmit ka pësuar lëndime trupore në kokë dhe dorën e majtë për të cilat lëndime ka kërkuar dhe marr trajtim mjekësor për një kohë më të gjatë. Për më shumë, në deklaratimet e tij, i dëmtuari ka pranuar se gjatë gjithë kohës ka tentuar që të mbrohet nga sulmi fizik i të pandehurve.

Bazuar në ekspertimin mjekoligjor nga Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML), i datës ...0..20.. për të dëmtuarin S. B., vërtetohet fakti se i dëmtuari në këtë rast ka pësuar dy plagë - Plagë shqyese në pjesën anësore të kokës dhe në gishtin e katërt të dorës së majtë. Sipas akt ekspertimit mjekoligjor, konstatohet se për shkak të këtyre dy plagëve, i dëmtuari ka pësuar lëndime trupore të natyrës së lehtë trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin e tij.

Sipas raportit mjekësor nga Spitali “.....” me numër të protokollit; i datës ...0..20.. në emër të dëmtuarit S. B., vërtetohet se i dëmtuari ka kërkuar ndihmë mjekësore dhe se është trajtuar pas ngjarjes. Sipas raportit, konstatohen plagët që ka pësuar i dëmtuari, siç janë, plagë në kokë dhe në gishtin e katërt të dorës së majtë. Raporti përshkruan edhe ndihmën dhe mjekimin e ofruar për të dëmtuarit, si, pastrimi i plagës, qepja, fashimi dhe përshkrimi i terapisë.

Bazuar në raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes, i hartuar nga policia e Kosovës - Njësia e Forenzikës, i datës 16.05.2023 përshkruhet ngjarja në bazë të informatave që janë siguruar në terren, ku ndër të tjera, theksohet se i dëmtuari S.B ditën e ngjarjes është rrahur nga dy persona, përkatësisht nga të pandehurit A. dhe E.G. Më tutje në raport, theksohet se i dëmtuari është dërguar për trajtim mjekësor në Qendrën Emergjente në V., ndërsa, dy të pandehurit janë arrestuar për këtë rast. Po ashtu, është evidentuar se në vendin e ngjarjes janë gjetur dëshmitë, një ombrellë e dëmtuar, një kapak i telefonit dhe një palë syze. Ndërsa, pas arrestimit dhe gjatë kontrollit të ushtruar te i pandehuri A.G është gjetur një thikë me teh prej 6 cm, por që nuk vërehet se ka njolla gjaku në të.

Sipas foto-albumit të datës 16.05.2023 nga Njësia e Forenzikës së Policisë, me përmbajtje gjithsej (9) nëntë fotografi, evidentohen dhe shihen sendet dhe gjurmët që janë hasur në vendin e ngjarjes. Në mesin e sendeve, shihet një ombrellë e dëmtuar, një kapak i telefonit dhe një palë syze si dhe një thikë e fotografuar pas sekuestrimit nga i pandehuri A.G.

Bazuar në mendimin e ekspertit mjeko-ligjor Dr. M.G paraqitur gjatë shqyrtimit gjyqësor, vërtetohet se i dëmtuari S.B., ka pësuar dy plagë, një në kokë në anën e majtë dhe plagën tjetër në gishtin e dorës së majtë. Sipas mendimit të ekspertit, plagët që ka pësuar i dëmtuari, kualifikohen si lëndime të leha trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin e tij.

Nga mendimi i eksperti mjeko-ligjor Dr. M.G, të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor rreth llojit të plagës së shkaktuar te i dëmtuari dhe mjetit të mundshëm me të cilin janë shkaktuar plagët, sipas

tij ekzaminimi i lëndimeve të dëmtuari është bërë në bazë të dokumenteve të çështjes dhe raportit mjekësor nga Qendra Emergjente në, me numër të datës ...0..20.. ku përshkruhet diagnoza e lëndimeve si: VLC (vulnus lacero contusio - plagë shqyese) capitis regio reg.parietales et mani dig. IVL.sin, të cilat dëmtime paraqesin *plagë shqyese* në pjesën anësore të kokës dhe në gishtin e 4 të dorës së majtë. Për më shumë, ka shtuar se, me besueshmëri se në këtë rast këto dëmtime janë të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbrehtës (jo të mbrehtë) dhe si të tilla lëndimet kualifikohen me natyrë të lehtë trupore me pasoja të përkohshme shëndetësore. Në këtë aspekt edhe e ka korrigjuar akt ekspertimin që e ka dhënë me shkrim, ashtu që të veprimi mekanik i mjetit të fortë dhe të mbrehtë duhet të korrigjohet dhe të jetë veprimi mekanik i mjetit të fortë mbrehtës (jo të mbrehtë). Sipas tij, se ka një mospërputhje në raportin e mjekimit për të dëmtuarin, përkatësisht në mes të asaj që është thënë në anamnezë dhe në diagnozë. Te pjesa e anamnezës, përshkruhet mjete i mbrehtë ndërsa në diagnozë përshkruhet “*plagë shqyese*”. Eksperti ka sqaruar këtë mospërputhje dhe sipas tij, anamneza merret dhe nga vet deklarimi i palës mbi atë se si është zhvilluar ngjarja, ndërsa diagnoza përshkruhet pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të pacientit nga mjeku dhe merret për bazë gjatë vlerësimit.

Nga dëgjimi në cilësi të dëshmitarit të Dr. A.D, i cili ka përpiluar raportin e mjekimit për të dëmtuarin S.B në Qendrën Emergjente në V., me numër të datës ...0..20.. i cili ka deklaruar se pacienti ka pasur lëndime në kokë dhe në dorë. Në anamnezë ka konstatuar i therur për faktin se i dëmtuari ashtu ka deklaruar. Sipas tij, te pjesa e anamnezës shënohet ajo çka deklaroi vetë pacienti i (dëmtuari). Dëshmitari ka shtuar se qëndron pas raportit që ka dhënë lidhur me mjekimin e të dëmtuarit dhe edhe njëherë ka përshkruar gjendjen në të cilin ishte sjellë i dëmtuari për mjekim dhe veprimet që ka ndërmarr në këtë rast. Shton se “gjendja e plagës ka qenë shqyese dhe depërtuese, plaga ka pasur gjakderdhje dhe qepje. Sipas tij, diagnoza është shkruar në bazë të asaj çka i njëjti ka parë në plagë dhe pastaj është shënuar; *plaga shqyese- prerëse (VLC), vulnus është plagë, Lacero është prerëse- shqyese dhe Contuzum është kontuzion*.

Nga dëgjimi i dëshmitarit Dr. A.D, dhe dëgjimi i ekspertit mjeko-ligjor Dr. M.G, edhe lidhur me llojin e plagëve, ka theksuar se plaga prerëse dhe plaga shqyese janë dy koncepte të ndryshme. Si njëra edhe tjetra kanë karakteristikat e veçanta dhe mbi bazën e tyre mund të nxjerrën përfundime mbi mjetin e mundshëm që është përdorur për shkaktimin e tyre. Te plaga prerëse, mjete është me maje dhe teh, ndërsa tek plaga shqyese mjete nuk ka maje e as teh. Sipas tij, ka shumë karakteristika që i dallojnë këto dy plagë. Plaga prerëse shënohet në diagnozë si “*Vulnues Scissum*” (dhe puvtum) që do të thotë plagë prerëse (shpuese ose therrëse), ndërsa plaga shqyese

shënohet si “VLC” që nënkupton “Vulnus Lacero Contusio” e që do të thotë plagë shqyese e ndrydhëse, që të dy këto plagë gjakderdhin dhe kanë nevojë për qepje. Nga diagnoza e lëshuar nga raporti mjekësor për të dëmtuarin S. B., rezulton shënimi se plaga ka qenë *VLC pra, plagë shqyese dhe jo prerëse në regjionin muror të kokës dhe në gishtin e katërt të dorës së majtë*. Krejt në fund, eksperti Dr. M.G nuk ka përjashtuar mundësinë që çelësat e automjetit të jenë përdorur si mjet për shkaktimin e lëndimeve trupore për të dëmtuarin.

Nga deklarata e të pandehurit E. G. gjatë deklarimit të tij në polici, i njëjti ka thënë se ditën kritike ka qenë duke shkuar në bankën “T.” në V. dhe aty e ka takuar të dëmtuarin S.B të cilin e njihnte si figurë. Sipas tij, i dëmtuari ka filluar që ta shaj si dhe e ka marrë një bisht të fshesës në një lokal, mirëpo kanë ndërhyrë disa kalimtarë të rastit dhe i kanë ndarë. Shton se është nisur drejtë stacionit të policisë dhe rrugës e ka thirr të vëllain e tij, të pandehurin A., të cilit i ka treguar për rastin dhe se do të shkon në polici për të paraqitur rastin. Në deklarimin e mëtejshëm, ka thënë se kur ka arrit para stacionit policor, ka ardhur i dëmtuari S. i cili e ka sharë dhe e ka goditur me diçka në kokë me një mjet të fortë por që nuk e ka parë se çka ka qenë ku ka vazhduar me goditje. Pastaj ka thënë, se: “unë ja kam kthye goditjet me grushta dhe në grusht kam pas çelësat e veturës, aty kanë ndërhy disa njerëz në mes dhe na kanë nda, pastaj ka mbërrit policia dhe na ka dërguar në stacion policor”. Sipas tij, deri te kjo përleshje ka ardhur për shkak të një mosmarrëveshje që e kanë pasur me të dëmtuarin rreth dy vite më parë për një parcelë pronësore në V. Edhe në deklaratën që ka dhënë në prokurori dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka pranuar se me të dëmtuarin ka pas problem edhe me herët, para këtij rasti, rreth një prone. Gjithashtu, ai pranon se edhe ditën kritike kanë pas një mosmarrëveshje verbale me të dëmtuarin, gjersa ka qenë afër bankës T.. Në shqyrtimin gjyqësor, lidhur me ngjarjen kryesore, i pandehuri ka deklaruar, se, i dëmtuari e ka sulmuar i pari me grushta dhe me një ombrellë, ndërsa ai vetëm është mbrojtur nga sulmi i të dëmtuarit. Sipas tij, atë ditë në dorë ka pas çelësat e automjetit dhe gjatë kohës sa është përlesh me të dëmtuarin - sa është mbrojtur nuk e përjashton mundësinë të ketë godit të dëmtuarin me çelësa në kokë. I pandehuri mohon pretendimin se e ka sulmuar të dëmtuarin me thikë apo se ka poseduar ndonjë thike gjatë përleshjes me të dëmtuarin, siç pretendohet në akuzë.

Nga deklarata e të pandehurit A.G në shqyrtim gjyqësor, i njëjti ka deklaruar se të dëmtuarin S. nuk e ka njohur më herët. Sa i përket ditës kritike ka thënë se, ka qenë duke shkuar për ta nënshkruar një kontratë të kredisë në bankën “T.”, me vëllain e tij, E.. Sipas tij, E. e ka takuar te udhëkryqi i spitalit, i cili i ka treguar për rastin apo konfliktin që ka pas me të dëmtuarin, dhe se do ta praqes rastin në polici. Më tej, ka shtuar se, gjersa kanë qenë para stacionit policor, ka

ardhur i dëmtuari S., e ka sharë dhe e ka sulmuar E. I pandehuri shton se, ai nuk ka marr pjesë në rrahje, mirëpo, ka tentuar që t'i ndaj palët dhe gjatë kësaj përpjekje thotë se edhe vet ka pësuar lëndime trupore. I pandehuri, ka pranuar se ka poseduar një thikë (brisk), mirëpo shton se për asnjë çast nuk e ka nxjerr thikën e as nuk e ka sulmuar të dëmtuarin, siç pretendohet në aktakuzë.

Nga raportet mjekësore për të pandehurit E. dhe A.G nga Qendra Emergjente- Spitali “....” në, aktekspertimi nga Instituti i Mjekësisë Ligjore i datës, foto albumi nga vendi i ngjarjes, si dhe mendimi i ekspertit mjekoligjor Dr. M.G, rrjedh se të pandehurit E. dhe A.G, kanë pësuar lëndime për të cilat janë konstatuar lloji dhe natyra lëndimeve. I pandehuri E. G. ka pësuar ndrydhje të indeve të buta në kokë, të cilat paraqesin lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme. Ndërsa, i pandehuri A. G. ka pësuar ndrydhje të indeve të buta në regjionin e qafës dhe regjionin e syrit të djathtë, të cilat paraqesin lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme. Për më shumë, të pandehurit në deklaratimet e tyre, kanë thënë se ditën kritike kanë pësuar lëndime trupore. Sipas tyre, lëndimet u'a ka shkaktuar i dëmtuari S. B.

Andaj, kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se pretendimet e mbrojtëses në drejtim të vërtetimit jo të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike janë të pabazuara ngase me provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, e të cilat janë pjesë e shkresave të lëndës, rezulton se në këtë çështje penale janë vërtetuar faktet si në përshkrim të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar për të cilën edhe i akuzuari është shpallur fajtor për këtë vepër penale.

Sa i përket pretendimit ankimor të shkeljes së ligjit penal, kjo Gjykatë një pretendim të tillë e gjen si të pabazuar për faktin se, duke qenë se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë rrjedh se në këtë rast edhe zbatim i ligjit penal nga gjykata e shkallës së parë, me rastin e rikualifikimit të veprës penale, si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, është i drejtë ngase nga provat e administruara kanë rezultuar si të provuara tiparet e veprave penale të rikualifikuara - gjegjësisht për veprimet e përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar përmbushen të gjitha elementet e figurës së veprës penale Sulm nga neni 184 par.1 të KPRK-së në raport me të pandehurin A.G si dhe të gjitha elementet e veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 e lidhur me par.1 nenpar.1.4 të KPRK-së në raport me të akuzuarin E. G., andaj edhe ky kolegji penal vlerëson si të drejtë dhe ligjor përfundimin e shkallës së parë ndërsa pretendimet e mbrojtëses së të akuzuarit A.G av. L.K.G. i refuzoi si të pabazuara, ngase është vërtetuar se i pandehuri A.G ditën kritike e ka sulmuar të dëmtuarin me grushta në

gjoks dhe në kokë. Këtë e ka pohuar edhe vet i dëmtuari, këto veprime të pandehurit përshkruhen edhe në aktakuzë. Andaj, në bazë të veprimeve të pandehurit ditën e ngjarjes si dhe nga provat që gjenden në lëndë vërtetohet se sulmin fizik ndaj të dëmtuarit i akuzuari A. e ka ndërmarr vetëm me grushta dhe nga këto veprime të tij nuk mund të dëshmohej se i dëmtuari ka pësuar ndonjë dëmtim trupor, ashtu që gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka konstatuar se në veprimet e të pandehurit A.G përmbushen të gjitha elementet e veprës penale, *sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së*, konkludim të cilin në tërësi e mbështet edhe ky kolegji penal i Gjykatës së Apelit si të drejtë dhe të ligjshëm. Në raport me të pandehurin E. G., duke u bazuar në të gjitha dëshmitë e rastit Gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se i akuzuari E. ditën kritike e ka sulmuar të dëmtuarin me një mjet të fort, të përshtatshëm dhe të rrezikshëm duke ia shkaktuar një plagë në kokë dhe në gishtin e katërt të dorës së majtë, që nënkupton se të dëmtuarit i është shkaktuar vetëm *një plagë në kokë në pjesën anësore e cila cilësohet si dëmtim i lehtë trupor me pasoja të përkohshme trupore*. Në anën tjetër, nuk ka mund të vërtetohet se i pandehuri ka përdorë thikën për të sulmuar të dëmtuarin. Ndërsa, dëmtimi që ka pësuar i dëmtuari në kokë ka mund të shkaktohet me përdorimin e çfarëdo mjeti të fortë, sepse plaga ka qenë (shqyese) e që nuk përjashtohet të jenë shkaktuar me përdorimin për sulm të çelësave të automjetit. Këto rrethana tregojnë qartë se i pandehuri nuk ka përdorur ndonjë mjet të destinuar ekskluzivisht për shkaktimin e dëmtimeve me pasoja të mëdha, siç mund të ishin, (armët e zjarrit apo armët e ftohta) që me përdorimin e tyre drejtpërdrejt do të rrezikohej jeta e të dëmtuarit. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka elaboruar edhe ecurinë e ngjarjes së ndodhur në rastin konkret duke theksuar se të pandehurit para sulmit e kanë përcjellur të dëmtuarin për një kohë dhe po të kishin qëllim për ta privuar nga jeta të dëmtuarin, kanë pas kohë të mjaftueshme dhe mundësi për realizimin e qëllimit si ka pretenduar akuzua. Megjithatë, edhe pse ditën e ngjarjes i pandehuri A. ka poseduar një mjet të përshtatshëm - thikë, kështu që, të pandehurit do të mund ta përdornin këtë mjet-thikën për të sulmuar të dëmtuarin, duke marr parasysh se prezent kanë qenë dy të pandehurit, marr parasysh edhe fizikun e të pandehurve të cilët janë të moshës së re, po të kishin dashjen dhe qëllimin për ta privuar nga jeta të pandehurin, lehtë do të mund ta vënin nën kontroll të dëmtuarin dhe ta arrinin një qëllim të tillë. Andaj, mbi këto rrethana gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurit E. përmbushen elementet e veprës penale të *Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 e nën par 1.4 të KPRK-së*.

Gjykata e Apelit, duke vlerësuar pretendimet ankimore përkitazi me vendimin mbi dënimin, gjen se pretendimet e përfaqësuesit të palës së dëmtuar S.B av. SH.Z. për një dënim më të ashpër në

njërën anë si dhe ato të mbrojtëses së të akuzuarit A.G av. L.K.G. dhe mbrojtëses së të akuzuarit E.G. av. S.K.S. për një dënim më të butë, nuk janë të bazuara.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, për të pandehurit E. dhe A.G ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit sipas nenit 69 të KPRK-së ashtu që si rrethanë rënduese, gjykata ka pasur parasysh shkallën e lartë të dashjes të shprehur nga të pandehurit në këtë rast, motivin e sulmit si shkak i problemeve të mëhershme me të dëmtuarin, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë të tyre, kontributin esencial secili për veprimet e tij, cenimi i vlerës së mbrojtur e që është cenuar personaliteti dhe integriteti trupor i të dëmtuarit, mënyra e kryerjes së veprës penale, sepse para ngjarjes, i pandehuri E. ka pasur një konflikt verbal me të dëmtuarin dhe shkak i kësaj, të pandehurit e kanë përcjell të dëmtuarin dhe e kanë sulmuar në një vend publik, nuk kanë shprehur pendim e as keqardhje dhe nuk e kanë kompensuar të dëmtuarin për dëmin e pësuar. Gjithashtu, i pandehuri E. edhe para dy viteve ka pas problem me të dëmtuarin për shkak të një prone, ashtu që, Prokuroria Themelore në Mitrovicë, lidhur me këtë rast, kundër të pandehurit E. G. ka ngritur aktakuzë për veprën penale, vrasje në tentativë ku sipas aktakuzës, i pandehuri E. G. akuzohet dhe dyshohet se ka tentuar që ta privoj nga jeta të dëmtuarin S. B. Lënda është e regjistruar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, me numër të rastit P.nr.256/2022. Në raport me të pandehurin E.G. është e rëndësishme të theksohet se i njëjti edhe më parë ka qenë i dënuar në dy raste, për vepra penale; lëndim i lehtë trupor dhe armëmbajtje pa leje, ndaj tij zhvillohen edhe 5 (pesë) raste apo procedura tjera penale për vepra të rënda penale. Ndërsa, si rrethana lehtësuese, Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar faktin se lëndimet që i janë shkaktuar të dëmtuarit janë të natyrës së lehtë, me pasoja të përkohshme, të pandehurit janë të moshës relativisht të re. I pandehuri E. është baba i dy fëmijëve të vegjël, mbajtës i familjes. Ndërsa, në raport me të pandehurin A. si rrethana lehtësuese janë vlerësuar, se nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale, nuk njihet për precedent penal, ka treguar sjellje shumë korrekte, sulmi i tij ndaj të dëmtuarit nuk ka rezultuar me pasoja.

Gjykata e shkallës së parë të akuzuarve A.G dhe E. G. iu shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprat penale me të cilat ngarkohen të njëjtit dhe se Gjykata ka vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet qëllim i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, se të pandehurit në të ardhmen do të përmbahen nga veprimet e paligjshme dhe do të bëhet rehabilitim i tyre, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalohen

kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e dënimit, ndërsa pretendimet e paraqitura nga përfaqësuesi i palës së dëmtuar S.B av. SH.Z. për shqiptimin e një dënimi më të lartë për të akuzuarit, këto rrethana tashmë ishin vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë ndërsa në ankesë nuk thekson ndonjë rrethanë të re apo se cilat rrethana gjykata nuk i ka vlerësuar, ndërsa pretendimet e paraqitura nga mbrojtësja e të akuzuarit A.G av. L.K.G. dhe mbrojtësja e të akuzuarit E. G. av. S.K.S. për dënime më të ulëta për të akuzuarit janë pretendime të pabazuara ngase të gjitha këto rrethana të cekura si në ankesë janë vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, andaj edhe ky kolegji penal, nga këto rrethana të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë, vlerëson se si të tilla japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti për Krime të Rënda
PAKR.nr.50/2024, datë 20.06.2024

Bashkëpunëtor Profesional,

Anëtarët e kolegjit,

Kryetare e kolegjit,

Bajram Rexhahmetaj

Vaton Durguti

Afërdita Bytyçi

Skender Çoçaj